



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kačanik

Zyra e Kryetarit

01Nr.104/02-13638/19

Kaçanik, 06.05.2019

Në mbështetje të neneve 17 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 73 të Statutit të Komunës, pas propozimit të drejtorisë së Emergjencave dhe Shërbimeve Publike, kryetari i komunës nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. Për formimin e grupit punues për hartimin e Planit për Reagim Emergjent për territorin e Komunës së Kaçanikut me këtë përbërje:

1. Bujar Bajra zyrtar për alarmim dhe koordinim emergjent,
2. Ylber Shehu shefi NjPZSH -së,
3. Naser Kuka inspektor i mbrojtjes nga zjarri,
4. Nebi Murseli zyrtar i emergjencave

II. Grupi punues ka për obligim të bëjë identifikimin e detyrimeve ligjore të dala nga ligjet sektoriale, për nxjerrjen e akteve të caktuara komunale për çështje të emergjencave.

III. Grupi punues obligohet që menjëherë të filloj punën në hartimin e Planit për Reagim Emergjent për territorin e Komunës së Kaçanikut, të cilën më pas e dërgon për miratim në Kuvendin Komunal.

IV. Grupi punues punën e vet, e bën në përputhje të plotë me Ligjin Nr.04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, Ligji Nr. 04/L-012 për Mbrojtje nga Zjarri, Ligji Nr. 04/-L-049 për Zjarrëfikje dhe Shpëtim, duke pasur parasysh nevojat dhe specifikat e komunës së Kaçanikut.

V. Për punën e vet grupi punues raporton dhe koordinohet me drejtorin e Drejtorisë së Emergjencave dhe Shërbimeve Publike.

VI. Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Drejtoria e Emergjencave dhe Shërbimeve Publike.

VII. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Besim Ilazi

Kryetar i Komunës



Me këtë vendim njoftohen:

1. *Ramadush Osmani, drejtor i DESHP,*
2. *Grupi punues dhe*
3. *Arkivi*



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Kryetari i Komunës

01.Nr *104/02-14542/19*

Kaçanik, 15.05.2019

Kryetari i komunës së Kaçanikut, duke u bazuar në nenin 73 pika 2 dhe 12 e Statutit të Komunës së Kaçanikut, duke u bazuar Kontratën mbi ndërtimin 01Nr.2156/09 e datës 25.03.2009, e lidhur për ndërtimin e objektit banesor-afarist 2B+S+P+6+NK në ngastrën kadastrale 650-3 mes kryetarit të Komunës dhe ndërmarrjes "Çlirimtarët", merr këtë:

V E N D I M

I

Për emërimin e anëtarëve të komisionit për shqyrtimin e kontratës 01Nr.2156/09 e datës 25.03.2009, në përbërje prej:

Betim Shala, inxhinier i ndërtimit, zyrtar në DUKMM- kryetar i komisionit
Jehona Dervishi, inxhinier e arkitekturës, zyrtare në DUKMM,
Mentor Shehu, inxhinier i gjeodezisë, zyrtar në DUKMM
Ilir Koraqi, inxhinier i ndërtimit, zyrtar në DESHP,
Rufat Muqa, inxhinier i arkitekturës, zyrtar në DUKMM,
Çlirim Troni, ekonomist, zyrtar në DEFZH, dhe
Murat Burrniku, jurist, zyrtar i personelit

II

Anëtarët e emëruar të komisionit, të shqyrtojnë të gjithë dokumentacionin ekzistues të marrëveshjes për ndërtimin e objektit 2B+S+P+6+NK, në ngastrën kadastrale 650-3, zona kadastrale Kaçanik



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/Municipality of Kačanik
Zyra e Kryetarit



01.Nr 104/02-14946/19

Kaçanik, 20.05.2019

Në bazë të nenit 58, pika h, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, të nenit 73 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

**PËR THEMELIMIN E KËSHILLIT ORGANIZATIV KOMUNAL PËR
KREMTIMIN E "11 QERSHORIT"- DITA E ÇLIRIMIT E KOMUNËS SË
KAÇANIKUT**

1. Me këtë vendim themelohet këshilli organizativ komunal për kremtimin e "11 qershorit"- dita e çlirimit e Komunës së Kaçanikut, me anëtarët si në vijim:
 1. Ylber Bajra – koordinator i këshillit;
 2. Izahir Doda – anëtar;
 3. Bahri Selimi – anëtar;
 4. Fatlume Selimi – anëtare;
 5. Festim Neziraj – anëtar;
 6. Ismajl Murseli – anëtar;
 7. Fatos Vishi – anëtar;
 8. Remzije Dardhishta – anëtare;
 9. Hajrulla Shehu – anëtar;
 10. Ruzhdi Gjini – anëtar, dhe
 11. Muharrem Ahmetaj – anëtar.
2. Përbërja e këtij këshilli është bërë në formën që të ketë gjithëpërfshirje të të gjithë akterëve të cilët mund të kontribuojnë në kremtimin e përvjetorit.
3. Detyrat kryesore të këshillit janë që të organizojnë takime dhe të përzgjedhin formën më të mirë të shënimit të kësaj dite shumë të rëndësishme, përfshirë programin artistik, organizimin, orarin, ftesat, çështjet teknike, sportin etj.
4. Mandati i këshillit si në pikën 1. të këtij vendimi, përfundon me rastin e shënimit të kësaj dite, gjegjësisht më 12.06.2019.
5. Ky vendim bëhet i plotfuqishëm me rastin e nënshkrimit të tij.

I dërgohet:

Anëtarëve

Arkivit



Kryetari i Komunës

Z. Besim Ilazi